



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KONTRATË MBI PUNËN

Kuvendit Komunal të Novobërdës në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik Dua arch SH.P.K.; Pro & Co Group SH.P.K., me sili ne Gjilan(ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Asfaltimi i rrugës Stanishor -Strazh komuna e Novobërdës
me numër identifikues: Nb 654 2020 10 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Asfaltimi i rrugës Stanishor -Strazh komuna e Novobërdës me numër identifikues: NB 654-20200 521

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **79.935.50 €**; [Shtatëdhjet e nëndmij e nëndëqindë e tridhjet e pesë euro e pesëdhjet centë]

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen nga AK sipas situacioneve të punës të aprovuara nga Organi Mbikëqyrës por jo më shumë se me tri situacione në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [shqipe]¹ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Fatos Ahmeti
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	28.08.2020
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Drenushë Ulshim
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	28.08.2020
Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Ligji në fuqi në Republikën e Kosovës.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% E VLERES SE KONTRANTE
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rrezeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar

Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda TRI ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është konform planit dinamik të dorëzuar sipas afatit të përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë TRI DIT PAS NENSHKRIMT TE KONTRATES
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë plani dinamik i kompanisë POR JO ME GJAT SE 30 ditë kalendarik .
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 %e Çmimit final të Kontratës..
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është : Do te emërohet me vendim nga kryetari i komunës
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është:N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: N/A
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë maximum 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 365 ditë Periodha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimi teknik të përkohshëm në shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontratës, për defektet e paraqitura në objekt sipas Dokumentit Polisës së Sigurimit e lëshuar nga një Bankë ose Kompani e Sigurimeve e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, ndërsa 3 vite mbi bazën e dhënies të Deklaratës me shkrim të pakushtëzuar, nga Kryesi i Punëve, për garantimin e cilësisë së punëve të përfunduara – pranuar dhe përgjegjësisë pa kushtëzim për defektet e paraqitura në objekt.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara
Parimet e	18.1	Orari i pagesës do të jetë: Pagesat do Bëhen nga MZHR dhe AK Sipas

përgjithshme të pagesës		<i>situatave të punëve të kryera e të aprovuara nga organi Mbikëqyrës dhe menaxheri i kontrates por jo më shumë se tri Stuacione</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<i>shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</i> ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh <i>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë</i>

PARAMASA DHE PARALLOGARIA							
ASFALTIMI I RRUGËS STANISHOR -STRAZHË							
A	ASFALTIMI I RRUGËS						
Nr.	POZICIONI	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH (€)	TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Vlera totale me TVSH(€)
	Vërejtje: Pozicionet në paramasë përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin e materialeve, fuqinë punëtore, atestet e nevojshme, mekanizimin dhe puniminin e pozicionit me të gjitha aktivitetet dhe materialet, si dhe shqyrtimi i të gjitha shtresave të rrugës në laborator sipas kërkesës së investitorit						
1	PROJEKTI I RRUGËS						
1.1	INÇIZIMI DHE PUNET PARAPRAKË NË TEREN						
1.1.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtës për punë si dhe largimi i instalimeve në punishtë në rast se ka në ato hapësira.	m'	1,530.00	0.04	0.01	0.05	76.50
1.1.2	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontroll të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në zgjerimet e rrugës	m'	1,530.00	0.04	0.01	0.05	76.50
1.1.3	Shenimi i trasesë, si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit	m'	1,530.00	0.08	0.02	0.10	153.00
	TOTALI:1.1						306.00
1.2	PASTRIMI I TERENIT						
1.2.1	Demolimi i të gjitha llojeve të strukturave nga betoni dhe trotuarave me gur skajor, prerja e drunjeve dhe shkulla të tyre në të dy anët e rrugës ,në këtë pozicion të kalkulohet edhe largimi i materialit të demoluar deri në depoini më 10 km	m'	1,530.00	0.12	0.03	0.15	229.50
1.2.2	Zhvendosja e shtyllave elektrike,PTT,Ndriqimit në vendin ku e percakton autoriteti kompetent.	cope	1.00	36.90	8.10	45.00	45.00
1.2.3	Ngritja e pusëve ekzistuese deri në nivelin e rrugës në të gjitha elementet.	cope	1.00	12.30	2.70	15.00	15.00
	TOTALI:1.2						289.50
1.3	PUNËT TOKËSORE						
1.3.1	Largimi i shtresës së asfaltit ekzistues, demolimi,ngarkimi dhe transportimi i materialit të demoluar	m ²	4,200.00	0.16	0.04	0.20	840.00
1.3.2	Prerja e asfaltit të demtuar, sanimi i gropave në pjesët ku asfalti është demtuar me bitozhavor 0-22 mm, me trashësi 7 cm, duke përfshirë dhe materialin për stabilizim të trupit të rrugës. Për sanimin e asfaltit të demtuar referojuni Situacionit në projekt.	m ²	600.00	2.95	0.65	3.60	2,160.00
1.3.3	Gërmimi i dheut i kategorisë II-III dhe humusit, duke përfshirë edhe kyqjet ,me ngarkim dhe bartje deri në depoini në largësi më 10km.	m ³	480.00	0.41	0.09	0.50	240.00
1.3.4	Formesimi ,perpunimi dhe ngjeshja e bazës ekzistuese e trupit të rrugës me ngjeshmeri 30 MN/m ² , përfshihen edhe kyqjet.	m ²	5,300.00	0.12	0.03	0.15	795.00
1.3.5	Furnizimi dhe punimi i bankinave me material jokoherent, planifikim dhe ngjeshja t=10cm	m ²	840.00	0.57	0.13	0.70	588.00
1.3.6	Hapja e kanaleve për largimin e ujërave , (1.00-1.5) m ³ /m', me transport të materialit G.J.M.T. 10km.	m'	1,530.00	0.41	0.09	0.50	765.00
	TOTALI:1.3						5,388.00

[Signature]



Nr.	POZICIONI	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH (€)	TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Vlera totale me TVSH(€)
1.4	KONSTRUKSIONI I TRASËS SË RRUGËS						
1.4.1	Furnizimi dhe punimi i tamponit (60MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=30cm , perfshihen edhe kyqjet. -Sasia e llogaritur në gjendje të ngjeshur si vijon:	m ³	1,590.00	3.94	0.86	4.80	7,632.00
1.4.2	Furnizimi dhe punimi i tamponit (80MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=10 cm , ne kete shtrese eshte llogaritur edhe sasia per rregullimin e gjeometrise ne kthesa dhe ne drejtim,perfshihen edhe kyqjet. Sasia e llogaritur në gjendje të ngjeshur si vijon:	m ³	550.00	3.94	0.86	4.80	2,640.00
1.4.3	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e bituagregatit 0-22mm , t=7cm(duke përfshirë sanimet, udhëkryqet dhe rrugët lidhëse)	m ²	4,250.00	4.92	1.08	6.00	25,500.00
1.4.4	Pastrimi i sipërfaqes se pergjitheshme te trases dhe lysterja me emulsion per pergaditjen e shtreses se dyte te asfaltit	m ²	7,700.00	0.08	0.02	0.10	770.00
1.4.5	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltbetonit 0-11mm ,t=5cm (duke përfshirë sipërfaqen e pergjitheshme te rruges kryesore)	m ²	7,700.00	3.94	0.86	4.80	36,960.00
	Punim i lëshesave gypore terthore te rruges nga betoni i armuar , (të mbështjella me beton) me koka hyrëse dalëse nga betoni C25/30, duke përfshirë edhe armimin e kokave me armature rrjete 18/200mm , me diametër :						
1.4.6	Ø600mm	m'	25.00	14.76	3.24	18.00	450.00
TOTALI:1.4							73,952.00
REKAPITULIMI I PERGJITHSHEM							
ASFALTIMI I RRUGËS STANISHOR -STRAZHË							
Nr.	Pozicioni					Vlera(€)	
1.1	INÇIZIMET DHE PUNET PARAPRAKE NE TEREN					306.00	
1.2	PASTRIMI I TERENIT					289.50	
1.3	PUNËT TOKËSORE					5,388.00	
1.4	KONSTRUKSIONI I TRASËS SË RRUGËS					73,952.00	
TOTALI I PERGJITHSHEM ME TVSH							79,935.50
Vërejtje: Segmenti kryesor L=840 m' duhet të punohet ne dy shtresa asfalt kurse pjesa tjeter e rrugës është vetem për sanimin e asfaltit të demtuar dhe ne kete pjese do te punohet vetem nje shtrese asfalt sipas situacionit në projekt.							

REKAPITULIMI I PERGJITHSHEM

dh



Nr.	POZICIONI	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH (€)	TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Vlera totale me TVSH(€)
PARAMASA DHE PARALLOGARIA							
ASFALTIMI I RRUGËS STANISHOR -STRAZHË							
Nr.	Pozicioni						Vlera(€)
A	ASFALTIMI I RRUGËS						79,935.50
TOTALI I PERGJITHSHËM ME TVSH							79,935.50

Vendite: Ju lutem beni verifikimin e formulave te llogaritjes per tu siguruar se gjithcka eshte ne regull

[Signature]

Emri i OE:	DUA ARCH BPPK
Data:	21.07.2020k
Vula:	
Nenshkrim:	

